



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 1/2018**

9 shkurt 2018

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, si në vijim:

- Rregullore nr. Xx/2017 mbi kërkesat për ofruesit e shërbimeve në lidhje me trajnimin dhe vlerësimin e kompetencës për personelin e elektronikës të sigurisë të trafikut ajror (ATSEP)

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik sipas kërkesave të nenit 5, pika 5.2 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012, përkatësisht nga data 14 deri me 28 dhjetor 2018. Pas kërkesës për shtyerje të afatit të konsultimit publik nga ana e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), afati u zgjat deri më 12 janar 2018.

Neni 5, Pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 thotë që: “AAC-ja do të aplikojë procedura transparente për konsultimit publik të palëve të interesuara nëpërmes:

- a) Metodës së pranimit të komenteve dhe vërejtjeve me shkrim me anë të mjeteve elektronike të komunikimit (adresë elektronike zyrtare) apo dorëzimit të tyre personalisht ; dhe/ose
- b) Organizimit të takimeve publike me palët e interesuar”

Në rastin e kësaj rregulloreje konsultimi publike me palët e interesuara, u realizua sipas pikës 5.1, a) dhe b) të udhëzimit të lartëcekur.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

Thirrjes së dërguar për konsultim publik të palëve të interesit i janë përgjigjur dy persona fizik, të cilët kanë paraqitur vërejtjet/sugjerimet e tyre nëpërmes postës elektronike zyrtare të AAC-së. Pas shqyrtimit të vërejtjeve të pranuar, u pa e nevojshme organizimi i një takimi me palët e interesuara për të sqaruar aspekte të projekt rregullores të cilat ishin komentuar gjatë fazës së konsultimit publik. Palët e interesuara u ftuan në takim konsultues i cili u mbajt më 24.01.2018. Gjatë këtij takimi, u vendos për një takim të dytë përcjellës, i cili u mbajt më 30.01.2018.

II. 1. Vërejtjet/sugjerimet e pranuar me shkrim

Në vijim janë të pasqyruara vërejtjet/sugjerimet e pranuar në formë origjinale siç janë dërguar dhe pranuar në AAC për projekt-rregulloren e lartpërmendur, ndërsa në formë të përmbledhur janë paraqitur vërejtjet/përgjigjet e AAC-së, si dhe ndërhyrjet në tekst të projekt-rregullores, aty ku është konsideruar relevante. Duhet cekur se disa nga përgjigjet e

AAC-së janë hartuar duke pasur parasysh edhe përfundimet e arritura gjatë takimeve konsultuese me palët e interesuara.

Rradhitja e shqyrtimit të komenteve/sugjerimeve është bërë në bazë të radhitjes kalendarike të pranimit të komenteve dhe/ose sugjerimeve nga palët, nëpërmes adresës elektronike.

1. *“Trajnimi per ATSEP eshte obligativ per gjithë personelin e KNV. -Trajnim BASIC ATSEP eshte obligativ per te ghithe, ekipi qe kujdestaron ne dhome te monitrimin dhe ne nivelin e I-re te mirembajtjes nuk e ka te perfunduar Trajnimin BASIC ATSEP, perveq dy teknikeve. Ky trajnim ne disa shtete te rajonit zgjate mes 4 dhe 6 javeve. Te dhena te nxjera nga Kongresi i IFATSEA-as ne Shkup 2011, ku kam qene pjesemarres.”*

(Dërguar nga Bujar MURSELI, DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 13:57 min).

1. Përgjigje e AAC-së:

Neni 3 Pika 3.1 dhe 3.2, e Projekt-rregullores thotë:

“3.1 Ofruesi i shërbimeve që punëson ATSEP do të krijojë një program të trajnimit dhe vlerësimit të kompetencës për të mbuluar detyrat dhe përgjegjësitë që duhet të kryhen nga ATSEP, për të siguruar që personeli i ofruesit të shërbimit të jetë i trajnuar dhe kompetent në kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të sigurt, efikase, dhe të qëndrueshme.

3.2 Ofruesi i shërbimeve duhet të krijojë politika për trajnimin e personelit të ATSEP;”

Projekt-rregullorja lë në diskrecion të organizatës organizimin dhe strukturimin e trajnimit dhe mirëmbajtjes së kompetencës për stafin ATSEP. Rregullorja kërkon që organizata të hartojë një një program të trajnimit dhe vlerësimit të kompetencës, e cila do të adresonte çështjet e ngritura nga komentuesi.

2. *“ Trajnimi QUALIFICATION ATSEP eshte obligativ per te gjithë personelin e secilit sektor veq e veq(COM/MET, SURVEILANCE, NAV). Kohezgjatja 6 deri 8 jave”-”*

(Dërguar nga Bujar MURSELI, DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 13:57 min).

2. Përgjigje e AAC-së:

Siç është përkrahur në nenin 3, projekt-rregullorja lë në diskrecion të organizatës organizimin dhe strukturimin e trajnimit dhe mirëmbajtjes së kompetencës për stafin ATSEP. Rregullorja kërkon që organizata të hartojë një një program të

trajnimin dhe vlerësimin të kompetencës, e cila do të adresonte çështjet e ngritura nga komentuesi.

3. *“Trajnimi RATING është obligativ vetëm për ata që në QUALIFICATION ATSEP arrijnë rezultate me të mira për sektorët për të cilët trajnohen. Aty caktohen ne baze të rezultateve Udheheqesit dhe Specialistet e Sektoreve. Kohezgjatja e trajnimit 8-12 javë.”*

(Dërguar nga Bujar MURSELI, DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 13:57 min).

3. Përgjigje e AAC-së:

Siç është përshkruar në nenin 3, projekt-rregullorja lë në diskrecion të organizatës organizimin dhe strukturimin e trajnimit dhe mirëmbajtjes së kompetencës për stafin ATSEP. Rregullorja kërkon që organizata të hartojë një program të trajnimit dhe vlerësimin të kompetencës, e cila do të adresonte çështjet e ngritura nga komentuesi.

4. *“Trajnimi ON JOB ATSEP zgjate 2 muaj”*

(Dërguar nga Bujar MURSELI, DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 13:57 min).

4. Përgjigje e AAC-së:

Siç është përshkruar në nenin 3, projekt-rregullorja lë në diskrecion të organizatës organizimin dhe strukturimin e trajnimit dhe mirëmbajtjes së kompetencës për stafin ATSEP. Rregullorja kërkon që organizata të hartojë një program të trajnimit dhe vlerësimin të kompetencës, e cila do të adresonte çështjet e ngritura nga komentuesi.

5. *“Para se të fillohet me implementimin e Trajnime ATSEP, personeli duhet të shkollohet dhe të certifikohet me nivel të IV- a të gjuhës angleze, sipas predispozitave për Departmente të Kontrollit Ajror”*

(Dërguar nga Bujar MURSELI, DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 13:57 min).

5. Përgjigje e AAC-së:

Neni 5 i Projekt rregullores në verzionin final është amandamentuar për të pasqyruar vërejtjen e lartshënuar, si dhe konkludimet e takimeve publike të mbajtura.

6. *“Në pjesën Neni 5 “Zotësia gjuhësore” mendoj që do të duhej të jetë më shumë e precizuar. Mendoj që do të duhej të jetë më shumë e precizuar se cili nivel i gjuhës është i domosdoshem*

për ATSEP-a në nivel nacional. Nëse kjo pjesë nuk rregullohet sikur që është e rregulluar për kontrollorët, të pakten të definohen siq është e definuar në ESARR 5.”

(Dërguar nga Driton Mehaj, Drejtor i DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 14:56 min).

6. Përgjigje e AAC-së:

Neni 5 i Projekt rregullores në verzionin final është amandamentuar për të pasqyruar vërejtjen e lartshënuar, si dhe konkludimet e takimeve konsultuese të mbajtura.

7. *“Në pjesen Neni 12 mendoj se do të duhej që të precizohet më në detaje “Vlerësimi i kompetences”. Përseri, nëse nuk definohet në nivelin e rregullores për kontrollorë, të pakten të definohet sipas rekomandimeve të “Udhëzuesit për Vlerësimin e kompetences për ATSEP.”*

(Dërguar nga Driton Mehaj, Drejtor i DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 14:56 min).

7. Përgjigje e AAC-së:

Siç është përshkruar në Nenet 3, 11 dhe 12 të saj, projekt-rregullorja lë në diskrecion të organizatës organizimin dhe strukturimin e trajnimit dhe mirëmbajtjes së kompetencës për stafin ATSEP. Rregullorja kërkon që organizata të hartojë një një program të trajnimit dhe vlerësimit të kompetencës, e cila do të adresonte çështjet e ngritura nga komentuesi.

8. *“Hyrja në fuqi është precizuar se do të jetë me 1 janar 2019. Kam rezervoat e mia në lidhje me atë se a do të mbërrij ASHNA të mbërrijë ti plotësoj kërkesat e kësaj rregulloreje bazuar në buxhetin që e ka.”*

(Dërguar nga Driton Mehaj, Drejtor i DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 14:56 min).

8. Përgjigje e AAC-së:

Në verzionin final të projekt-rregullores është shtuar Neni mbi dispozitat kalimtare, që mundëson zbatimin e neneve specifike të rregullores në një datë më të vonshme se data e zbatimit e specifikuar në Nenin 15 të projekt-rregullores origjinale.

9. *“Rregullorja në fjalë mendoj se do të duhej të përmbaj më shumë të dhëna për “medical fitness”.*

(Dërguar nga Driton Mehaj, Drejtor i DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 14:56 min).

9. Përgjigje e AAC-së:

Përshtatshmëria mjekësore (“*medical fitness*”) është jashtë fushë-veprimit që rregullon kjo projekt-rregullore, prandaj vërejtja nuk është marrë parasysh.

10. “Mendoj se rregullorja në fjalë do të duhej të precizoj shpeshhtësinë e trajnimeve rifreskuese, të pakten në mënyrën siq është kjo e rregulluar me dokumentin e ICAO-s.”

(Dërguar nga Driton Mehaj, Drejtor i DTEK, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, dt. 12 janar 2018, ora 14:56 min).

10. Përgjigje e AAC-së:

Siç është përshkruar në Nenet 3 dhe 10 të saj, projekt-rregullorja lë në diskrecion të organizatës organizimin dhe strukturimin e trajnimit dhe mirëmbajtjes së kompetencës për stafin ATSEP. Rregullorja kërkon që organizata të hartojë një një program të trajnimit dhe vlerësimit të kompetencës, e cila do të adresonte çështjet e ngritura nga komentuesi.

II. 2. Vërejtjet/sugjerimet e pranuar dhe diskuatuar gjatë takimeve konsultuese

Në vijim janë paraqitur përmbledhjet e takimeve konsultuese që janë mbajtur me palët e interesuara, të rradhitura në mënyrë kronologjike.

1. Takimi i parë, i mbajtur më 24.01.2018

Takimi i parë konsultues u mbajt më datën 24.01.2018, në ora 10:00, në zyrat e AAC-së. Takimi u thirr nga AAC, me qëllim të sqarimit të disa prej çështjeve që ishin ngritur gjatë periudhës së konsultimit publik me shkrim përmes postës elektronike.

Në këtë takim morrën pjesë:

1. Driton Mehaj, Menaxher i Departamentit Teknik, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA)
2. Merita Makolli, Menaxhere e Departamentit për Zhvillim dhe Trajnime, ASHNA
3. Alban Sylaj, Shef i Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm, ASHNA

Ndërsa, nga AAC ishin prezentë:

1. Arianit Islami, Drejtor i Departamentit për Shërbime të Navigacionit Ajror
2. Muhamed Luta, Inspektor për Shërbime të Navigacionit Ajror
3. Zana Limani Fazliu, Inspektor për Shërbime të Navigacionit Ajror
4. Albulena Gërxhaliu, Inspektor për Shërbime të Navigacionit Ajror
5. Nora Bakalli, Këshilltare Ligjore për Çështje Ligjore të Aviacionit

Në takim u diskutuan 4 pika kryesore të përmbledhura më poshtë:

1. Përcaktimi i nivelit të zotësisë së gjuhës

Gjatë takimit u diskutuan dy vërejtjet e pranuar me shkrim të ndërlidhura më përcaktimin e nivelit të zotësisës së gjuhës për personelin teknik (ATSEP) (shih komentet me numër 5 dhe 6 në pjesën II.1). Përfaqësuesit e ASHNA-s potencuan se përcaktimi, apo definimi më i qartë, i kërkesave për njohjen e gjuhës nga personeli teknik ATSEP, ishte i nevojshëm, pasi që shumica e sistemeve dhe pajisjeve të cilat shfrytëzohen dhe mirëmbahen nga ASHNA janë të prodhuara jashtë Kosovës.

Përfaqësuesit e AAC-së, ndonëse u pajtuan me këtë konkludim, ngritën çështjen e zbatimit në praktikë të një kërkesë të tillë, sidomos sa i përket aspekteve të formës së testimit dhe mirëmbajtjes së zotësisës. Në veçanti, u diskutua mundësia e zbatimit të Niveleve të zotësisës së gjuhës angleze të përcaktuara nga ICAO, të cilat përdoren për personelin e licencuar, siç janë kontrollorët e trafikut ajor, pilotët, etj. Prandaj nga përfaqësuesit e ASHNA-s u kërkua që të hulumtonin përmes kontakteve të tyre profesionale në vendet tjera, për modalitetet e zbatimit të një kërkesë të tillë. Në ndërkohë, edhe përfaqësuesit e AAC-së do të hulumtonin praktikën më të mira nga aspekti rregullativ për adresimin e një kërkesë të tillë.

2. Data e hyrjes në fuqi

Gjatë takimit u diskutua edhe pika e ngritur nga z. Mehaj në lidhje me përgatitjen e ASHNA-së për zbatimin e plotë të rregullores deri në datën e paraparë për implementim sipas Nenit 15 (shih komentin me numër 8 në pjesën II.1). Duke pasur parasysh se buxheti për vitin 2018 për ASHNA veçmë ishte planifikuar dhe aprovuar nga ana e Ministrisë së Financave, si dhe duke e ditur se nuk do të kishte mundësi për ndryshime të mëdha në të, përfaqësuesit e AAC-së e konsideruan këtë vërejtje si të arsyeshme. Përfaqësuesit e AAC-së kërkuan nga përfaqësuesit e ASHNA-s të përpilonin një listë të neneve të cilat do të ishte vështirë të zbatohen brenda periudhës së paraparë në nenin 15, si dhe një afat kohor realist për zbatimin e plotë të tyre. Bazuar në këtë listë, projekt-rregullorja do të mund të amandamentohej për të përfshirë dispozita kalimtare për ato nene që do të konsiderohej e arsyeshme.

3. Përshtatshmëria mjekësore

Përfaqësuesit e AAC-së sqaruan se ky aspekt nuk është brenda fushëveprimit të kësaj rregulloreje, dhe se kjo çështje do të mbetet siç është e rregulluar me ligjet dhe rregulloret tjera të aplikueshme.

4. Shpeshësia e mbajtjes së trajnimeve përditësuese (*refresher training*)

Gjatë takimit u diskutua pika e ngritur nga z. Mehaj në lidhje shpeshësinë e trajnimeve rifreskuese (shih komentin me numër 10 në pjesën II.1). Nga përfaqësuesit e ASHNA-s u kërkua që ky aspekt i trajnimeve përditësuese të përcaktohet në nivel të rregullorës. Përfaqësuesit e AAC-së thanë se konsiderojnë se kjo çështje mund të adresohet më mirë nga vetë organizata, brenda Programimit të trajnimit dhe skemës për vlerësim, por se do të hulumtonin praktikën më të mira për të adresuar këtë çështje nga aspekti rregullativ.

Si përfundim, u vendos që një takim përcjellës të mbahet më datën 30.01.2018 për të përmbyllur konsultimin në lidhje me temat 1, 2 dhe 4.

2. Takimi i dytë, i mbajtur më 30.01.2018

Takimi i dytë konsultues u mbajt më datën 30.01.2018, në ora 10:30, në zyrat e AAC-së. Mbajtja e këtij takimi u dakordua nga gjitha palët në takimin paraprak, me qëllim të konsultimit final në lidhje me çështjet e mbetura hapura, pas realizimit të hulumtimeve nga dyja palët.

Në këtë takim morrën pjesë:

1. Driton Mehaj, Menaxher i Departamentit Teknik, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA)
2. Merita Makolli, Menaxhere e Departamentit për Zhvillim dhe Trajnime, ASHNA
3. Alban Sylaj, Shef i Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm, ASHNA

Ndërsa, nga AAC ishin prezentë:

1. Arianit Islami, Drejtor i Departamentit për Shërbime të Navigacionit Ajror
2. Muhamed Luta, Inspektor për Shërbime të Navigacionit Ajror
3. Zana Limani Fazliu, Inspektor për Shërbime të Navigacionit Ajror
4. Nora Bakalli, Këshilltare Ligjore për Çështje Ligjore të Aviacionit

Në takim u diskutuan 3 pika kryesore të përmbledhura më poshtë:

1. Përcaktimi i nivelit të zotësisë së gjuhës

Pas hulumtimeve nga dyja anët për praktikën më të mira të zbatimit të një niveli minimal të zotësisë së gjuhës angleze për stafin ATSEP, dyja palët u dakorduan që të ndiqet modeli i shfrytëzuar për kontrollorët e trafikut ajror. Rrjedhimisht si nivel minimal i zotësisë së gjuhës të përcaktohet niveli 4 sipas shkallës së ICAO-s, e cila është definuar në Aneksin I të ICAO-s. Ky nivel do të aplikohet vetëm për ATSEP që do ndjekin trajnimet e kualifikimeve dhe të sistemeve/pajsjeve specifike, jo edhe për ata që do të ndjekin trajnimin bazik. Si përfundim, përfaqësuesit e AAC-së u pajtuan të amandamentojnë Nenin 5 të projekt rregullores për të reflektuar dakordimet e arritura gjatë takimit.

2. Data e hyrjes në fuqi

Gjatë takimit të dyja palët u dakorduan që për nenet e rregullores që kanë të bëjnë me zotësinë e gjuhës, instruktorët për trajnime dhe vlerësuesit e kompetencës teknike do të lejohet mundësia për zbatim të mëvonshëm përmes dispozitave kalimtare.

3. Shpeshësia e mbajtjes së trajnimeve përditësuese (*refresher training*)

Përfaqësuesit e AAC-së njoftuan pjesëmarrësit në takim se pas hulumtimit të praktikave më të mira për rregullimin e trajnimeve përditësuese, kishin arritur në përfundim që kjo çështje duhej të adresohet nga vetë organizata përmes programit të trajnimit, pasi që shpeshësia e trajnimeve përditësuese varet nga shumë faktorë si kompetenca aktuale e stafit, kompleksiteti i ambientit operativ si dhe ndryshimet e planifikuara për të ardhmen. Rrjedhimisht, është vështirë të përcaktohet një periudhë e vetme në nivel kombëtar. Si përfundim, nenet e projekt-rregullores që prekin këtë çështje nuk do të amandamentohen.

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloret nën pikën I të këtij raporti, janë vlerësuar gjithsejt 10 vërejtje/komente me shkrim të cilat janë pranuar nga data 14 dhjetor 2017 - 12 janar 2018. Gjithashtu janë mbajtur dy takime konsultuese më 24 dhe 30 janar 2018, për të sqaruar më tutje komentet e pranuar.

Nga këto vërejtje/komente, janë pranuar nga ana e AAC-së tri (3) vërejtje për adaptim/përmirësim të tekstit të rregullores (komentet nr. 5, 6 dhe 8) të cilat do të inkorporohen në verzionin përfundimta të projekt-rregullores. Të gjitha komentet tjera kanë marrë përgjigjet adekuate.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti i Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Zyra për Çështje Juridike dhe Rregullatore